

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021

Ora 09:35

**RENDI I DITËS**

***Hedhja e shortit për “Caktimin e Relatorit të Kërkesave Ankimore nr.27, nr.28  
dhe nr.29”***

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje, pranë KQZ-së janë depozituar 3 kërkesa ankimore, Kërkesa Ankimore nr.27, Kërkesa Ankimore nr.28 dhe Kërkesa Ankimore nr.29 me ankues KZAZ nr.66, KZAZ nr.38 dhe Anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.2. Sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit, për shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura pranë KQZ-së. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, atëherë do të hidhet në prani të përfaqësuesve të KQZ-së. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në tre nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “Kërkesë Ankimore nr.27”, “Kërkesë Ankimore nr.28” dhe “Kërkesë Ankimore nr.29”, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Atëherë 5 shiritat janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë të tejdukshme. Një përfaqësues i Administratës së KQZ-së i vendos shiritat nëpër gogla dhe bën përzierjen e tyre. Sipas nenit 14 të rregullatores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi gogllën, sipas rendit alfabetik rritës, në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it.

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021

Ora 13:07

**RENDI I DITËS**

**Hedhja e shortit për “ Caktimin e Relatorit të Kërkesave Ankimore nr.30 dhe nr.31”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje, pranë KQZ-së janë depozituar 2 kërkesa ankimore, Kërkesa Ankimore nr.30 dhe Kërkesa Ankimore nr.31. Bazuar nenit 14 të rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit, për shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura pranë KQZ-së. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në dy nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “Kërkesë Ankimore nr.30” dhe “Kërkesë Ankimore nr.31”, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Atëherë 5 shiritat janë futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë të tejdukshme. Një përfaqësues i Administratës së KQZ-së i vendos shiritat nëpër gogla dhe bën përzierjen e tyre. Sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi gogllën, sipas rendit alfabetik rritës, në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it.

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

*Për Z. E. Lako:* Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.31.

*Për Z. E. Çefa:* Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Për Z. I. Rusmali:* Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Për Z. K. Bele:* Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Për Z. L. Braho:* Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.30.

Në përfundim të rezultatit të shortit Administrata e KQZ-së bën publik rezultatit e shortit nga i cili zoti Elvin Lako është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.31 dhe zoti Ledio Braho është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.30. Këtu mbyllet procedura e shortit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

*Për Z. E. Lako:* Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.29.

*Për Z. E. Çefa:* Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.27.


*Për Z. I. Rusmali:* Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Për Z. K. Bele:* Tërhiqet gogla - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Për Z. L. Braho:* Tërhiqet gogla - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.28.

Në përfundim të rezultatit të shortit Administrata e KQZ-së bën publik rezultatit e shortit nga i cili zoti Elvis Çefa është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.27, zoti Ledio Braho është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.28 dhe zoti Elvin Lako është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.29. Këtu mbyllet procedura e shortit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:11**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr.25 dhe nr.26 të subjektit  
ankues KZAZ-ja nr.33, Qarku Tiranë dhe KZAZ-ja nr.22, Qarku Durrës".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S'ka

**Z. E. Lako:** Çelim seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesave ankimore nr.25 të anëtarëve dhe Sekretarit të KZAZ-së nr.35, Qarku Tiranë dhe Kërkesën Ankimore nr.26 të anëtarëve dhe Sekretarit të KZAZ-së nr.22 Qarkut Durrës me objekt "Kundërshtimin e vendimeve nr.316 dhe 309, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe Sekretarrit të KZAZ-së nr.35 dhe nr.22". Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve datë 29.04.2021, vendosi të kalonte për shqyrtim dy kërkesat ankimore të sipërcituara. Relatorët e tyre përkatësisht zoti Ervin Lako dhe Ledio Braho, konstatuan se dy kërkesat ankimore kundërshtojnë sankionet administrative të vendosura nga Komisioneri në bazë të nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Të dy kërkesat janë inicuar nga KZAZ-të që ankimojnë vendimmarje të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që lidhen me afatin e parashikuar në pikën 1 të nenit 122 të

1

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

Kodit Zgjedhor. Bazuar në nenin 65, shkronja “ç”, të Kodit Procedura Administrative, KAS-i vendosi shqyrtim bashkarsisht të kërkesave ankimore nr.25 dhe nr.26 me relator zotin Ervin Lalo i cili u zgjodh relator për kërkesën e regjistruar më parë në regjistrin e ankimimeve. Të pranishëm në këtë seancë janë anëtarët e KAS-it, duke qenë në pamundësi për ta ndjekur seancën fizikisht bazuar në nenin 51 të Rregullores “Për mënyrën e funksionimit të zhvillimit të seancave të KAS-it”, zoti Elvis Çefa do ta ndjekë seancën ndërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në platformën e posacme që menaxhohet nga Administrata e KQZ-së. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, verifikojmë legjitimin procedural të palëve pjesmarrëse. Ka ndonjë të pranishëm nga anëtarët e KZAZ-ve?

**Z. Y. Merkaj:** Jo nuk ka asnjë.

**Z. E. Lako:** Nuk ka. Ndonjë kërkesë nga palët e interesuara?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk ka. Nuk është paraqitur asnjë kërkesë.

**Z. E. Lako:** Vazhdojmë seancën në mungesë të palëve, meqenëse këtu kemi administratën përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm shkurtimisht dy fjalë.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 26.04.2021 ka marrë vendime përkatësisht vendimin 316 dhe vendimin nr.309 për KZAZ-në nr. 35 dhe KZAZ-në nr.22. Pasi referuar nenit 122 pika 1 të Kodit Zgjedhor këto KZAZ nuk ishin përgatitur brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, tabela përmbledhëse të rezultateve e cila parashikon se jo më vonë se ora 22:00, e ditës së nesërme të votimit duhet të plotësonin tabelat përmbledhëse të rezultateve. Gjithashtu neni

2

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

119, pika 5, e Kodit Zgjedhor përcakton se procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimet e të gjitha kutive të pranuar si të rregullta nga KZAZ-ja. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-ve vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Duke qenë se në datën 26.04.2021, e cila është dita e nesërme e votimit deri në orën 22:00, këto KZAZ nuk kishin plotësuar këtë detyrim ligjor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi që t'i dënojë me gjobë duke qenë se kanë shkelur këtë dispozitë ligjore. Parashikuar në nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor ka dënuar me 3000 lekë gjobë të gjithë anëtarët e KZAZ-së nr.35 dhe KZAZ-së nr.22.

**Z. E. Lako:** Faleminderit. Ka ndonjë pyetje për administratën nga anëtarët e KAS-it?

**Z. I. Rusmali:** Sipas asaj që unë lexoj në vendim është që anëtarëve të këtij Komisioni i është vënë gjobë për shkak se kanë realizuar më pak se 50% të volumit të punës. Shifrën 50% ju e keni në ndonjë akt nënligjor tuajin?

**Z. Y. Merkaç:** Jo nuk ka akt nënligjor, por duke parë që procesi është shumë i ngadaltë dhe nuk po vazhdonin atëherë u vendos një kriter që kush është mbi 50%.

**Z. I. Rusmali:** Pyetja e dytë përveç KZAZ-ve që ju i keni penalizuar KZAZ-të e tjera në çlidhje ishin me plotësimin?

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë komisioni ri kërkoi për cilat KZAZ kanë ritmin më të ngadaltë të rinumërimit dhe nga këto KZAZ-të të cilat nuk ishin plotësuar ishin nën

3

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

50%, u nxorrën nga tabela nga IT dhe ishin 17 KZAZ që kishin këtë ritëm të ngadaltë. Pjesa tjetër ishte drejt fundit dhe u pa e arsyeshme të mos vendosin sanksion për këto KZAZ.

**Z. L. Braho:** Këto 17 KZAZ-të kishin ritëm më të ngadaltë numërim apo pezulluan procesin?

**Z. Y. Merkaj:** Kishin ritëm të ngadaltë në numërim.

**Z. L. Braho:** Kishte ndonjë KZAZ që në datë 26 prill, ora 22:00 kishte miratuar tabelën e rezultateve?

**Z. Y. Merkaj:** Po Pusteci më duket Memaliaj, Konispoli.

**Z. L. Braho:** Sa qendra votimi kanë këto?

**Z. Y. Merkaj:** Pusteci ka 7 qendra votimi; Konispoli ka 15 qendra nuk e di me saktësi.

**Z. I. Rusmali:** Numërimi për subjektet apo dhe për kandidatët?

**Z. Y. Merkaj:** Për subjektet ishte fjala.

**Z. K. Bele:** Ka pasur ndonjë analizë lidhur me si funksionon KZAZ-ja për çdo rast. Duke qenë se në Pustec kemi 7 qendra votimi, në Fier një KZAZ nëse nuk e kam fiksuar unë gabim janë 97. Pra idea është a kemi ne bindjen që vonesat me ndonjë





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

rast mund të ketë qenë objektive për arsye të ngarkesës, vendeve që e ngadalsonin procesin apo gjëra të tilla.

**Z. Y. Merkaj:** Përpara se të merrej vendimi Komisioneri Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore duke komunikuar në këto KZAZ dhe u pa dhe u arrit në konkluzion në përfundimin që asnjë nga këto arsye objektive për ngadalsimin e procesit dhe vendosi duke qenë se nuk ka arsye objektive të vazhdojë me sanksionim e gjobës.

**Z. K. Bele:** Dhe një pyetje a ka ndonjë rekomandim që sa orë një anëtar i KZAZ-së mund të punojë? Sa mund të jetë pushimi i domosdoshëm që e para ai të garantojë një objektivitet në vendimmarrjen e tij pra t'i punojnë sytë. Dhe në raport me disa norma që janë për analogji kur nget makinën pas dy orëve do të bësh një pushim ta rekomandojnë dhe këto aplikimet e gatshme. Nuk e di nëse ka një lloj orientimi. Pra, unë besoj nuk mund të pretendohet që dikush të punojë 15 orë rrjesht por ndoshta funksionon ndryshe.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ, i cili është kompetent për administrimin e zgjedhjeve dhe zbaton Kodin Zgjedhor. Duke qenë se Kodi Zgjedhor neni 22, 122 pika 1 ka përcaktuar se KZAZ-të brenda orës 22:00, të nesërmen së ditës së votimit, plotësojnë tabelën e rezultateve është zbatuar kjo dispozitë ligjore dhe nuk është parashikuar.

**Z. K. Bele:** Është e arsyeshme që të themi se supozimi logjik që këta të punojnë 24 orë non stop pa ndërprerje, apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Po neni 119, pika 5, thotë që numërimi vazhdon pa ndërprerje deri sa të dalë tabela përmbledhëse e rezultatit.

**Z. E. Lako:** Një pyetje këta janë gjobitur anëtarët dhe sekretarët e këtyre KZAZ-ve për momiratimin e tabelës përmbledhëse apo për mosnumërimin mbi 50% të kutive apo të qendrave të votimit në atë zonë zgjedhore?

**Z. Y. Merkaj:** Këta kanë marrë sanksionet pasi nuk kanë plotësuar tabelën për pjesën e rezultatit brenda orës 22:00, të datës 26. Duke qenë se ritmi është shumë i ngadaltë është marrë në qoftë se do të vazhdonte të ngadalsohej atëherë të përshkallëzojë dhe sanksionet ndoshta me shkarkim, ndoshta me gjoba më të mëdha më të rënda.

**Z. L. Braho:** Për të bërë një sqarim për pyetjen që bëri zoti Koli Bele, në fakt Kodi e ka një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 10 qendra votimi dhe për çdo tavolinë numërimi ka 2 grupe numërimi. Tani ajo vendimmarrja nuk sqaron asgjë sesa kanë numëruar sa nuk kanë numëruar. A është përgjegjësi e KZAZ-së apo jo? Kështu që meqënëse nuk ka një numër të caktuar për qendrash votimi për orë është marrë thjesht ora 22:00.

**Z. Y. Merkaj:** Idea është që KZAZ-ja është organi kompetent që administron zgjedhjet në zonat administrim zgjedhor. Duke qenë se është kompetente duhet të ishin marrë masat që t'i ndryshonte grupit e numërimit ose të njoftonte partitë për të zëvendësuar, për të plotësuar vakancat ose rasti më i keq të vazhdonte me dy anëtarë në qoftë se do të paraqiteshin brenda orarit të caktuar nga KZAZ-ja mund të vazhdojë me dy anëtarë grupi i numërimit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**Z. E. Lako:** Në vijim të pyetjes që bëri zoti Braho, a janë administruar nga KQZ-ja ndonjë material nga proceverbalet e mbajtura apo nga libri i protokollit të mbledhjeve të këtyre KZAZ-ve për të parë që këto KZAZ a i kanë zbatuar kërkesat ligjore në menaxhimin e procesit apo është kjo që thoni ju?

**Z. Y. Merkaç:** Nga komunikimi i KZAZ-të por dhe nga transmetimi që japin KZAZ-të gjatë numërimit që janë online dhe janë në kohë reale të dhënat që hedhin anëtarët e grupit të numërimit në lidhje me tabelën e rezultateve çdo qendër votimi pamë se ritmi ishte shumë i ngadaltë i tyre.

**Z. E. Lako:** Domethënë ju thjesht konstatuat ngadalësinë e ritmit nëpërmjet raportimeve jo masat që ka marrë KZAZ-ja për menaxhimin e procesit?

**Z. I. Rusmali:** Pse zgjodhët masën e gjobës dhe jo ndonjë nga mjetet alternative që jep Kodi KQZ-së për të ndërhyrë mbi veprimtarinë e administratës zgjedhore për ta disiplinuar, pse gjobë në këtë rast?

**Z. Y. Merkaç:** Komisioneri e vlerësoi që të ishte masa më efikase për të vazhduar procesin e numërimit të përshpejtuar, vendimmarrje e Komisionerit.

**Z. E. Lako:** Zoti Çefa keni ndonjë pyetje?

**Z. E. Çefa:** Faleminderit zoti drejtues i seancës jam i qartë. Nuk kam asnjë pyetje.

**Z. E. Lako:** Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 13:50**

**Z. E. Lako:** Atëherë KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 316 datë 26.04.2021 dhe nr.309 datë 26.04.2021 bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara në mbështetje të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr.3 datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator vendosi: Pranimin e Kërkesave Ankimore me nr.25 dhe nr.26 të anëtarëve dhe Sekretarëve të KZAZ-së nr.35 të Qarkut Tiranë dhe KZAZ-së nr.22 Qarkut Durrës. Shfuqëzimin e vendimeve nr.309, datë 26.04.2021 dhe nr.316 datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe heqjen e sanksionit administrativ ndaj anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-së nr.35 Qarku Tiranë dhe KZAZ-së nr.22 Qarkut Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, faleminderit.

**Vendim nr. 48**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:55**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.27, subjekti ankues  
KZAZ-ja nr.66, Qarku Berat"**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**                   **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ:**   **Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë depozituar 3 kërkesat ankimore, kërkesa ankimore numër 27, kërkesa ankimore numër 28 dhe kërkesa ankimore numër 29, të cilët ankimojnë vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përkatësisht vendimin numër 306, 318 dhe 313, datë 26.04.2021. Kundër këtij vendimi i cili ka vendosur sanksion administrativ me gjobë në vlerën 3 mijë lekë për secilin nga anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së 66, KZAZ-së 38 dhe KZAZ-së numër 2. Kundër këtyre vendimeve është bërë ankim nga të 3 KZAZ-të, brenda afatit ligjor dhe është drejtuar tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit numër 306, 318 dhe 313 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 26.04.2021. Duke qenë se nga ana formale e bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor i plotësojnë kërkesat si legjitimimin, afatin dhe kompetencën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesat duhet të pranohen për shqyrtim.

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Po 30 dhe 31 në vlerësimin tuaj?

**Z. Y. Merkaj:** Po dhe 30 dhe 31 janë në të njëjtat kushte, janë paraqitur brenda afatit ligjor, kundërshtojnë vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili është kompetencë e KAS-it, dhe e legjitimojnë në të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesat pasi çenohen interesat e anëtarëve të KZAZ-ve, të cilët janë vendosur sanksione me gjobë.

**Z. L. Braho:** Ylli i citon pak dhe relatorët sipas numrave?

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, kërkesa ankimore numër 27 është zoti Elvis Çefa, kërkesa ankimore numër 28 është zoti Ledio Braho, kërkesa ankimore numër 29 është relator zoti Elvin Lako, kërkesa ankimore numër 30 është zoti Ledio Braho dhe kërkesa ankimore numër 31 është zoti Elvin Lako.

**Z. L. Braho:** Atëherë duke qenë se zoti Elvis Çefa është duke ndjekur mbledhjen on line dhe për problematika teknike nuk mund të flasë, në lidhje me kërkesën ankimore numër 27, KAS-i u tërhoq për vendim dhe vendosi pranimin e kërkesës dhe kalimin për shqyrtim administrativ. Në lidhje me kërkesën ankimore numër 28, që si relator jam caktuar unë, e KZAZ-së numër 38, po ashtu KAS-i u tërhoq për vendim dhe vendosi pranimin për kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore.

**Z. E. Lako:** Atëherë dhe për kërkesat ankimore numër 29 dhe numër 31, KAS-i u tërhoq për vendim dhe vendosi kalimin e këtyre kërkesave për shqyrtim në seancë, për sa i përket,,

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**Z. L. Braho:** Edhe sa i përket kërkesës ankimore numër 30 po ashtu, KAS-i vendosi për kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore. Seanca, po ashtu KAS-i në zbatim të nenit 65, shkronja ç të Kodit të Procedurave Administrative, vendosi bashkimin e këtyre kërkesave ankimore dhe gjykimin në një çështje ku relator do të jetë zoti Elvis Çefa, i cili ka dhe kërkesën ankimore numër 27. Shqyrtimi administrativ i këtyre kërkesave bashkarisht është vendosur për nesër, në datë 05.05.2021, në ora 13:00.

**Vendimi nr. 49**

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:58**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.28, subjekti ankues  
KZAZ-ja nr.38, Qarku Tiranë".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**                    **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
- **Stafi KQZ:**    **Y.Merkaj, O.Peto**
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar, kërkesa ankimore numër 28 e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përkatësisht vendimin numër 318 datë 26.04.2021. Kundër këtij vendimi i cili ka vendosur sanksion administrativ me gjobë në vlerën 3 mijë lekë për secilin nga anëtarët dhe sekretarin KZAZ-së 38, Qarku Tiranë, është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe është drejtuar tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objekt kundërshtimin e vendimit numër 318, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 26.04.2021. Duke qenë se nga ana formale e bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor i plotësojnë kërkesat si legjitimimin, afatin dhe kompetencën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesa duhet të pranohen për shqyrtim.

**Vendimi nr. 50**

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:58**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.29, subjekti ankues  
KZAZ-ja nr.02, Qarku Shkodër".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore numër 29, subjekti ankues KZAZ-ja nr.02, Qarku Shkodër, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përkatësisht vendimin numër 313, datë 26.04.2021. Kundër këtij vendimi i cili ka vendosur sanksion administrativ me gjobë në vlerën 3 mijë lekë për secilin nga anëtarët dhe sekretarin KZAZ-së numër 2. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga KZAZ-ja numër 2, brenda afatit ligjor dhe është drejtuar tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objekt kundërshtimin e vendimit numër 313 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 26.04.2021. Duke qenë se nga ana formale e bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor i plotësojnë kërkesat si legjitimimin, afatin dhe kompetencën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesa duhet të pranohen për shqyrtim.

**Vendimi nr. 51**

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:59**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.30, subjekti ankues  
KZAZ-ja nr.20, Qarku Durrës".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore numër 30, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi i cili ka vendosur sanksion administrativ me gjobë në vlerën 3 mijë lekë për secilin nga anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së numër 20, është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe është drejtuar tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 26.04.2021. Duke qenë se nga ana formale e bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor i plotësojnë kërkesat si legjitimimin, afatin dhe kompetencën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesat duhet të pranohen për shqyrtim.

**Vendimi nr. 52**

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 13:55**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr.31, subjekti ankues  
KZAZ-ja nr.21, Qarku Durrës".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore numër 31, KZAZ-ja numër 21, e cila ankimon vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi i cili ka vendosur sanksion administrativ me gjobë në vlerën 3 mijë lekë për secilin nga anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së numër 21, është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe është drejtuar tek Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 26.04.2021. Duke qenë se nga ana formale e bazuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor i plotësojnë kërkesat si legjitimimin, afatin dhe kompetencën e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesat duhet të pranohen për shqyrtim.

**Vendimi nr. 53**

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.05.2021*

**04.05.2021  
Ora 14:01**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi "Bashkimi i kërkesave ankimore nr.27, 28, 29, 30, 31, subjekte  
ankuese KZAZ-ja nr.66, Qarku Berat , KZAZ-ja nr.38 Qarku Tiranë, KZAZ-ja  
nr.02, Qarku Shkodër dhe KZAZ-ja nr.20 dhe 21, Qarku Durrës".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis Çefa, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

**Z. L. Braho:** KAS-i në zbatim të nenit 65, shkronja ç të Kodit të Procedurave Administrative, vendosi bashkimin e këtyre kërkesave ankimore dhe gjykimin në një çështje ku relator do të jetë zoti Elvis Çefa, i cili ka dhe kërkesën ankimore numër 27. Shqyrtimi administrativ i këtyre kërkesave bashkërisht është vendosur për nesër, në datë 05.05.02021, në ora 13:00.

**Vendimi nr. 54**

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**

